

L I G J
Nr.8444, datë 21.1.1999

**PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7995, DATË 20.9.1995 “PËR
NXITJEN E PUNËSIMIT**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7995, datë 20.9.1995 bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“20. Me termin “grupe të veçanta” nënkuptohen punëkërkuessit: nëna me shumë fëmijë, persona me moshë mbi 50 vjeç, të rinj nën 18 vjeç, të papunë afatgjatë dhe persona nga familje nën nivelin e varfërisë.”

Neni 2

Neni 8 ndryshohet si vijon:

“Mbajtja e vendeve ekzistuese dhe krijimi i vendeve të reja të punës:

1. Shteti mbështet punëdhënësit që krijojnë dhe mbajnë vende të reja pune dhe punësojnë në to kandidatë të ofruar nga zyrat e punësimit. Mbështetja shtetërore realizohet nëpërmjet:

a) subvencionimit, në përqindje të caktuar, të kostove për sigurimet e detyrueshme dhe të pagës;

b) subvencionimit apo kreditimit për pajisjen e vendit të punës. Punësimi për personat me arsim universitar dhe nga grupe të veçanta nxitet me përparësi.

2. Zyrat e punësimit ndjekin situatat e falimentimeve dhe të pushimeve masive nga puna. Çdo punëdhënës ka të drejtë të kërkojë mbështetje në rast vështirësish, të krijuara nga forca madhore, të cilat e shpien atë në falimentim ose pushime masive nga puna.

3. Masat, afatet dhe kriteret, sipas të cilave punëdhënësit përfitojnë mbështetje për rastet e mësipërme, vendosen nga Këshilli i Ministrave.”

Neni 3

Neni 11 ndryshohet si vijon:

“Formimi profesional

1. Formimi profesional u shërben si punëkërkuessve edhe punëdhënëssve dhe realizohet nëpërmjet kurseve të mësimi teoriko-praktik dhe pjesëmarrjes në procese të posaçme pune.

2. Shteti mbështet krijimin e kapaciteteve për formimin profesional, në sasi dhe cilësi, nëpërmjet:

a) zhvillimit të sistemi të qendrave shtetërore të formimi profesional;

b) nxitjes, mbështetjes, bashkëpunimit me subjektet joshetërore të interesuara dhe punëdhënësit.

3. Çdo punëdhënës mund të kërkojë nga zyra kompetente e punësimit që të financohet,

të subvencionohet apo të kreditohet, për të siguruar formimin profesional të punëmarrësit apo të kandidatëve për punësim. Punëdhënësi ka, gjithashtu, të drejtë të kërkojë mbështetje për të krijuar në mjediset e ndërmarrjes së tij kurse formimi nëpërmjet punës, për qëllime të veta ose fitimi.

4. Zyrat e punësimit mbështesin kurset e formimit profesional nëpërmjet punës në ndërmarrjet që kanë mundësi potenciale për të rritur numrin e të punësuarve ose që ofrojnë formimin për profesione të kërkuara në tregun e punës.

5. Qendrat shtetërore të formimit profesional administrohen nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe ofrojnë:

- a. kurse pa pagesë për punëkërkuar të papunë që trajtohen nga zyrat e punësimit;
- b. kurse me pagesë për persona që e kërkojnë një gjë të tillë;
- c. mjedise dhe mjete logjistike kundrejt qirasë për subjekte që ushtrojnë formimin profesional.

6. Kriteret, sipas të cilave Shërbimi Kombëtar i Punësimit zbaton programet shtetërore në zbatim të dispozitave të mësipërme, vendosen nga Këshilli i Ministrave."

Neni 4

Në nenin 12 bëhen këto ndryshime:

- Titulli i nenit 12 "Fondi për formim" ndryshohet dhe zëvendësohet me fjalët "Pagesa e pjesëmarrjes në kurs".

Në pikën 1 fjalët "një fond përgatitjeje" ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët "pagesë për pjesëmarrje në kurs".

Neni 5

Në nenin 20 pika 3 në paragrafin B fjala "mbështetje" zëvendësohet me fjalën "subvencion".

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2303 datë 1.2.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**